



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:009643

Datë: 03.10.2022

Numri i dokumentit: 03484900

P.nr. 11/22

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa , në lëndën penale kundër të pandehurit Z.E nga Ferizaj , për veprë penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 te KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.54-5/18 e datës 18.01.2022 , jashtë seancës gjyqesore me dt.03.10.2022 merr këtë,

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.54-5/18 e datës 18.01.2022, e parashtruar kundër të pandehurit Z.E nga Ferizaj, për shkak të dyshimit se:

Nga data e pa vërtetuar e deri me datë 07.05.2021 në fsh. Sllatinë e Lepencit , Komuna Kacanik, saktësisht në shtëpinë e tij, në njehsorin elektrik me numër ..., tek i pandehuri është hasur një lidhje direkte jashtë pikës matëse në rrjetin elektrik, pa njehsor elektrik, me ç'rast energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare, dhe i njëjti ka siguruar shërbime të energjisë elektrike për të cilat dihet se mundësohet vetëm në shkëmbim të kompensimit duke shmangur pagesën për këto shërbime ,me ç'rast të dëmtuarës ...-se i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 336.44 € .

Me të cilën do të kryente veprën penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 te KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar pranë kësaj gjykate aktakuzën PP.nr.54-5/18 e datës 18.01.2022, kundër të pandehurit Z.E nga Ferizaj , për vepër penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 te KPRK-se.

Ne bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.14.09.2022, mirëpo nga ana e Stacionit Policor në Kaçanik jemi informuar se i pandehuri është i vdekur.

Andaj gjykata, bazuar në certifikatën e vdekjes nr. V ..., nr.i references ..., lëshuar në Zyrën e Gjendjes Civile në Kaçanik me dt...., konstatoi se i pandehuri Z. (Rr...) E. i lindur me dt... ne fsh. ..., me adresë të fundit të banimit në Ferizaj, ka vdekur me ... në Kaçanik.

Meqenëse vdekja e të pandehurit është pengese për ndjekje penale, gjykata vendosi që t'a Hudh aktakuzën PP.nr.54-5/18 e datës 18.01.2022.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 454 par.1 të KPP-së

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 11/22 date 03.10.2022

Sekretarja Juridike ,
Indira Beqa,

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.